

Syllabusi i lëndës

Lënda: Qytetërim islam

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 5

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 403

Fondi i orëve: 2+1

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: VII

Mësimdhënësi: Prof. Asoc. Dr. Sadik Mehmeti

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Vështrim qytetërimin islam që nga paraqitja e tij e deri në periudhën bashkëkohore, duke u fokusuar me theks të veçantë në praninë e qytetërimin islam në vendet tona. Prezantohen format e përhapjes dhe karakteristikat e qytetërimin islam ndër shekuj. Të njihen etapat kryesore të qytetërimin islam, pastaj bartësit kryesore të qytetërimin islam, shkollat, personalitetet që kanë vënë vulën në qytetërimin islam. Të njihen monumentet reprezentative të qytetërimin islam dhe ndërtuesit e tyre. Qytetërimi islam të shpjegohet dhe trajtohet si pjesë e pandashme e qytetërimin botëror.

Qëllimi i lëndës:

Qëllimi i kësaj lënde është që të hulumtohen fillet, zhvillimet, kahet, rrjedhat, karakteristikat dhe veçoritë kryesore të qytetërimin islam ndër shekuj. Theks i veçantë i kushtohet sidomos qytetërimin islam në trojet shqiptare. Të njihen etapat kryesore të qytetërimin islam ndër shekuj, pastaj bartësit kryesore të qytetërimin islam, shkollat, personalitetet që kanë vënë vulën në qytetërimin islam, monumentet reprezentative të qytetërimin islam dhe ndërtuesit e tyre. Synohet të ngritën debate dhe të zhvillohen diskutime, të paraqiten pikëpamje e botëkuptime që do të nxisin dhe do të provokojnë mendimin kritik tek studentët.

Me theks të veçantë synohet që me fakte dhe argumente objektive, reale e shkencore dhe përmes debateve dhe mendimit kritik, të paraqitet dhe të dëshmohet ndikimi dhe vendi i qytetërimin islam në kuadër të qytetërimin botëror. Qytetërimi islam për shkak të shtrirjes së tij kohore dhe hapësinore, për shkak të vlerave dhe veçorive që posedon, për shkak të monumenteve materiale dhe të shkruara dhe për shkak të përfaqësuesve dhe bartësve të tij, konsiderohet si pjesë e qytetërimin botëror, e në periudha të caktuara kohore, si prijëse dhe përfaqësuese dhe kampione e këtij qytetërimi. Qytetërimi islam shpjegohet dhe trajtohet si pjesë e pandashme e qytetërimin botëror.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij cikli të ligjëratave studenti do të jetë në gjendje që:

- Të shpjegoj fillet dhe etapat e zhvillimit të qytetërimit Islam.
- Të njoh burimet dhe bartësit fillestar të qytetërimit islam.
- Të dalloj karakteristikat dhe veçoritë e qytetërimit islam.
- Të paraqes në mënyrë objektive dhe të paanshme vlerat e qytetërimit islam.

Të diskutoj për vendin që qytetërimi islam zënë në kuadër të qytetërimit botëror.

- Të argumentoj nevojën për njohjen e qytetërimit islam në përgjithësi dhe të qytetërimit islam ndër shqiptarët në veçanti.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Mësimdhënia do të zhvillohet në formën e ligjëratave.
- Në nxitjen dhe provokimin e debateve ndër studentët.
- Me përfshirjen e studentëve në diskutime.
- Përmes punimeve të seminareve dhe kolekfiumeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Paraqitje e përgjithshme për lëndën. Njohja me pasqyrën e lëndës; kuptimi dhe lënda e studimit, si dhe metodat e studimit të lëndës së Qytetërimit Islam; Hyrje në historinë e Qytetërimit Islam (përkufizimet për qytetërimin dhe kulturën)

Literatura: Jëllmaz Ozakpënar, *Kultura dhe qytetërimi-një teori mbi qytetërimin*, Logos A, Shkup, 2003, f. 13-40); Prof. dr. Qazim Qazimi, *Histori e qytetërimit islam*”, Prishtinë, 2018.

Java e dytë: Karakteristikat dhe veçoritë e qytetërimit islam dhe epërsia e tij karshi qytetërimeve të tjera.

Literatura: Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Logos A, Shkup, 2002, f. 28-38.

Java e tretë: Periudhat e zhvillimi të qytetërimit islam; Shkencat dhe dituritë tek popujt myslimanë.

Literatura: Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Logos A, Shkup, 2002, f. 40-90)

Java e katërt: Sahifja (Karta-Kushtetuta) e Medinës si burim i qytetërimit islam; Nevoja për njohjen e Kartës së Medinës sot.

Literatura: Resul Rexhepi, *Karta e Medines (es-sahife) ose kushteturta e parë e shoqërisë islame*, “Edukata Islame”, nr. 58-59, Prishtinë, 1996, f. 55-77); Muhamed Hamidullah, *Muhammedi, a.s.*, Shkup, 2012.

Java e pestë: Pasqyrë mbi fillet dhe zhvillimin e artit islam; Karakteristikat dhe veçoritë e artit islam; Vendi që zë arti islam në mesin e artëve botërore.

Literatura: ***, *Si ta njohim Artin Islam*, Botim i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2000.

Java e gjashtë: Arti i kaligrafist arabe (llojet e kaligrafisë dhe shkrimeve arabe, përfaqësuesit kryesorë, shtrirja e kaligrafisë etj.)

Literatura: M. Ugur Derman, *Arti i kaligrafisë në Perandorinë Osmane*, në: “Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit islam”, vëllimi II, Tiranë, 2009, f. 627-634; Çiçek Derman, *Arti i dekoracionit në Perandorinë Osmane*, në: “Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit islam”, vëllimi II, Tiranë, 2009, 635-640.

Java e shtatë: Arkitektura dhe miniatura islame; (Krye)Arkitektët shqiptarë në kohën osmane.

Literatura: ***, *Si ta njohim Artin Islam*, Botim i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2000; Shyqri Nimani, *Arnavud – artistët shqiptar në Perandorinë Osmane*, Prishtinë, 2003).

Java e tetë: Kryearkitekti shqiptar në Perandorinë Osmane-Atik Sinani dhe objektet që ai ndërtoi; Mimar Sinani dhe objektet që ai ndërtoi; Kasem agai dhe Mehmet Isai dhe objektet që ata ndërtuan.

Literatura: Shyqri Nimani, *Arnavud – artistët shqiptar në Perandorinë Osmane*, Prishtinë, 2003, f. 74- 79 dhe 80-85.

Java e nëntë: Monumentet islame në trojet shqiptare (xhamitë, medresetë, sahat kullat etj.); roli dhe rëndësia e njohjes së tyre, historiku, themeluesit dhe gjendja e tyre sot.

Literatura: Aleksander Meksi, *Probleme dhe aspekte të arkitekturës së xhamive në Shqipëri, Edukata islame*”, nr. 73, 2004; Aleksander Meksi, *Arkitektura e xhamive në Shqipëri*, Tiranë, 2006.

Java e dhjetë: Monumentet islame në Kosovë (xhamitë, medresetë, sahat kullat etj.), historiku, ndërtuesit, karakteristikat dhe gjendja e tyre sot; Xhamitë monumentale në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Vushtrri, Rogovë, etj.

Literatura: Iljaz Rexha, *Monumente të kulturës islame të shek XV – XVI në Kosovë*, “Edukata Islame”, nr. 75, Prishtinë, 2004; Dr. Fejaz Drançolli, *Xhamia e Hadumit në Gjakovë*, Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr. XVIII-XIX, Prishtinë, 1994.

Java e njëmbëdhjetë: Hyrje në historinë e arsimit islam, periudha paramedresore, xhamitë, kuttabet/mektebet në Botën Islame etj.); Historia e arsimit islam, periudha e

medreseve; fillet e medreseve në Botën Islame, themeluesit e parë, shtrirja e tyre, forma, literatura, myderrizët etj.)

Literatura: Prof. dr. Ziya Kazeci, *Historia e arsimit islam*, Tiranë, 2001, f.33-60.

Java e dymbëdhjetë: Medresetë dhe shkollat islame në periudhën e Perandorisë Osmane.

Literatura: Ekmeludin Ihsanoglu, Institucionet studimore shkencore dhe arsimore osmane, kapitulli VIII, në: “Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit islam”, vëllimi I, Tiranë, 2009, f. 369-457.

Java e trembëdhjetë: Medresetë dhe shkollat islame në Kosovë (historiku, godinat, myderrizët, studentët, literatura etj.); Kutubhanet/bibliotekat islame në Kosovë.

Literatura: Dr. Jashar Rexhepagiq, Zhvillimi i shkollave dhe arsimit tek shqiptarët në Jugosllavi deri më 1918, Prishtinë, 1968; Sinani, Shaban. *Dorëshkrimet orientale dhe tradita kulturore e Shqipërisë*, "Perla", nr. 1-4, Tiranë, 2001. Shpuza, Gazmend. *Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*, "Perla", 1-4, Tiranë, 2001. Jashar Rexhepagiq, Faltore, institucione, qendra islame në Kosovë, “Edukata islame”, nr. 65, Prishtinë, 2001.

Java e katërbëdhjetë: Institucioni i vakëfit dhe roli i tij në përhapjen e qytetërimit islam; Roli i vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimit islam në vendin tonë

Literatura: Osman Nuri Topbash, Vakëfi dhe zeqati, Stamboll, 2008; Sadik Mehmeti, Roli i vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimit islam në vendin tonë, Takvim/Kalendar, 2009, Prishtinë, f. 125-147.

Java e pesëmbëdhjetë: Kultura kombëtare shqiptare islame (veshja, traditat shpirtërore dhe materiale etj.)

Literatura: Dr. Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Logos A, Shkup, 2002.
2. Prof. dr. Qazim Qazimi, “*Histori e qytetërimit islam*”, Prishtinë, 2018.

3. Jëllmaz Ozakpënar, “*Kultura dhe qytetërimi – një teori mbi qytetërimin*”, Logos A, shkup, 2003.

Literatura shtesë:

4. Dr. Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i shkollave dhe arsimit tek shqiptarët në Jugosllavi deri më 1918*, Prishtinë, 1968.

5. Osman Nuri Topbash, *Vakëfi dhe zeqati*, Stamboll, 2008).

6. Iljaz Rexha, *Monumente të kulturës islame të shek XV – XVI në Kosovë*, “Edukata Islame”, nr. 75, Prishtinë, 2004.